



**Universiteti i Prishtinës  
Fakulteti Juridik**

**Programi i Zyrës së Dekanit 2020-2024: *Parimet,  
objektivat dhe procesi i vendimmarrjes***

***1 tetor 2020***

## Fjala hyrëse e Dekanit

Të nderuar anëtarë të personelit akademik,  
Të dashur studentë,

Kam kënaqësinë që t'ju drejtohem me këtë fjalë hyrëse, duke shprehur falënderimin për besimin që më keni dhënë për të qeverisur me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në mandatin e ardhshëm katër vjeçar. Një përgjegjësi të tillë e konsideroj si udhërrëfyes për të qeverisur në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe efikase, duke e njohur e respektuar kontributin dhe pjesëmarrjen e secilit nga ju, me qëllim që të garantojmë se institucioni ynë do të vazhdojë të avancojë rolin dhe imazhin e tij në komunitetin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë e më gjerë.

Përmes kësaj fjale hyrëse, dëshiroj që të paraqesë para jush përmbajtjen e një programi qeverisës katër vjeçar, i cili mendoj se përfaqëson misionin dhe vizionin me të cilin ju e keni ngarkuar Zyrën e Dekanit. Sigurisht, përgjegjësia për të qeverisur nuk mund të jetë e zbrazët: ajo është e ngarkuar me detyrë për të zbatuar në mënyrë shembullore legjislacionin në fuqi, aktet e tjera normative të Universitetit të Prishtinës, e për të ndjekur me përpikëri standardet e etikës akademike. Një detyrë të tillë mendoj që e kam paraqitur në mënyrë relativisht shteruese në këtë Program.

Programi që paraqes sot para jush ka tri shtylla kryesore:

**(1) Respektimi rigoroz i parimit të ligjshmërisë** në procesin qeverisës të Fakultetit Juridik. Institucioni ynë do të jetë, siç realisht duhet të jetë, shembull i zbatimit të përpiktë e të guximshëm të çdo standardi ligjor. Këtij parimi ne do t'i japim peshë në veprimtarinë tonë qeverisëse: atij duhet t'i japim kuptim përmes zbatimit të plotë në praktikë, pavarësisht nëse interesi i ngushtë i secilit prej nesh mund të vihet në pyetje.

**(2) Transparenca dhe llogaridhënia** në qeverisjen e Fakultetit Juridik. Vendimet e Zyrës së Dekanit, të çdo instance administrative, por edhe marrëdhënia jonë me organet qendrore të UP-së, do të jetë tërësisht e hapur, e qasshme për secilin dhe e bazuar në një premisë llogaridhënëse ndaj secilit, e të gjithëve pa dallim. Zyra e Dekanit do të jap përgjegjësi për çdo veprim të saj, dhe do t'i nënshtrohet një raportimi e informimi të rregullt kolektiv ndaj Këshillit si dhe individual ndaj secilit anëtar të personelit akademik.

**(3) Planifikimi strategjik** i kontributit të secilit në veprimtarinë e përgjithshme të Fakultetit Juridik. Fakulteti ynë do të shndërrohet në një institucion që reflekton një qeverisje të planifikuar, me prioritete strategjike, e me pritshmëri për detyrat e secilit dhe të definuara mirë që në fillim. Planifikimi do të përfshijë çdo fushë të qeverisjes, nga mësimdhënia e reformat kurrikulare e deri tek aktivitetet publike të institucionit. Kontributi i secilit nga ne është thelbësor në zhvillimin dhe ngritjen e rolit dhe të imazhit të Fakultetit Juridik në komunitetin e arsimit të lartë në Kosovë dhe me gjerë. Zyra e

Dekanit nuk është mekanizmi i vetëm i veprimit e i vetëpromovimit. Ajo është aty për të promovuar, organizuar e motivuar punën e personelit akademik, të studentëve dhe institucionit në përgjithësi. Prandaj, me këtë Program parashohim një format më modern, e të bazuar në një veprim kolektiv të qeverisjes, ku prioritetet strategjike të institucionit janë të planifikuara mirë dhe ku ngecjet, lëshimet apo edhe dështimet eventuale parashikohen e parandalohen shumë seriozisht.

Të nderuar kolegë,

Programi që paraqes para jush si Dekan i Fakultetit është një kontribut solid në këtë ndërmarrje të përbashkët qeverisëse. Ju ftoj që të kemi mirëkuptim në zbatimin e secilit objektiv zhvillimor për Fakultetin tonë edhe në rastet kur ne do të jemi të detyruar që për hir të një reforme serioze të ndryshojmë praktika të mëparshme e të gabuara. Një mirëkuptim të tillë do ta zhvillojmë duke komunikuar, debatuar dhe menduar në mënyrë konstruktive dhe të mbështetur në argumente me gjithsecilin nga ju. Qeverisja pa debat nuk ka kuptim. Kam pritje reale që pas çdo debati e komunikimi, secili nga ne të jemi në krye të detyrës për të avancuar pozitën dhe imazhin e Fakultetit Juridik. Misionin tonë të përbashkët për t'i dhënë institucionit një perspektivë zhvillimore, qeverisje të pastër e të ndershme, dhe ngritje të imazhit publik do ta bëjmë të mundshëm bashkërisht.

*Sinqerisht,*

Prof.Ass.Dr. Avni Puka - Dekan

## Misioni:

Fakulteti Juridik ofron një hapësirë të mendimit të lirë intelektual, në të cilin procesi mësimor dhe hulumtues duhet të zhvillohet në përputhje me standardet më të larta akademike, dhe ku studenti e personeli akademik aspirojnë të ndërtojnë një marrëdhënie të bazuar në dije, literaturë bashkëkohore e hulumtim shkencor, që ka vlerë origjinale e në përputhje me parimet më të larta etike.

## Vizioni:

Fakulteti Juridik aspiron të jetë një komunitet akademik e studentor që gëzon një konkurrueshmëri të lartë në tregun akademik e mësimor, që ka qasje të lehtë, prani të lartë dhe gëzon respekt të veçantë në tregun profesional të punës, që kontribuon thelbësisht në shkencën juridike përmes literaturës origjinale dhe të botuar ndërkombëtarisht, i cili bashkëpunon me shkollat elitë të fushës juridike, dhe i cili ka një shkëmbim të madh të personelit akademik e studentëve ndërkombëtarë.

## Vlerat e Fakultetit Juridik:

1. Fakulteti Juridik është i përkushtuar që të ofrojë mësim në fushën e shkencave juridike në përputhje me standardet më të larta akademike, etikën akademike dhe një dimension të pasur të ndërtimit të shkathtësive praktike dhe bashkëkohore tek studentët e tij në pajtim me trendët e kohës, kërkesat e tregut dhe nevojat e shoqërisë;
2. Fakulteti Juridik respekton dhe udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, i nënshtrohet rregullave etike, dhe zbaton masat e duhura ligjore ndaj atyre që pretendojnë të përfitojnë në mënyrë jo etike nga procesi mësimor e intelektual;
3. Fakulteti Juridik promovon zbatimin e parimit të barazisë dhe të meritës për personelin akademik, personelin administrativ dhe studentët;
4. Fakulteti Juridik ka rol aktiv në shmangien e konfliktit të interesit dhe nepotizmit në të gjitha fushat e veprimit të tij, si dhe në instalimin e një kulture të tillë përmes procesit mësimor dhe akademik;
5. Fakulteti Juridik si institucion dhe përmes personelit të tij kontribuon në forcimin e shtetësisë së Kosovës, sundimin e ligjit dhe zhvillimin e demokracisë në përgjithësi.
6. Fakulteti Juridik aspiron të ndërtojë një klimë të debatit aktiv, kritik, e intelektualisht të arsyetuar ndërmjet personelit të tij, studentëve, dhe të ofrojë një alternativë akademike në opinionin publik;
7. Fakulteti Juridik ofron një mjedis akademik, që shquhet për integritet të lartë të personelit dhe studentëve, me një kulturë të bazuar në respektin e ndërsjellë pavarësisht dallimeve personale, e me një karakter serioz apolitik e apartiak, tërësisht akademik dhe të pavarur në kuptimin ideologjik;

8. Fakulteti Juridik si institucion funksionon ne frymën e solidaritetit, humanitetit dhe ndihmës reciproke në mes anëtarëve të personelit akademik.
9. Fakulteti Juridik e çmon rolin thelbësor të studentit në zhvillimin e mendimit kritik, cilësive të lidërshiptit dhe shërbimit ndaj kërkesave profesionale të tregut në mënyrë të planifikuar. Ai i qëndron besnik parimit që aktiviteti studentor duhet të zhvilloj raportin mësimdhënës-student, dhe të promovoj një kulturë të mësimi bazuar në literaturë moderne e debat aktiv ndërmjet tyre;
10. Fakulteti Juridik është shembull i një imazhi të besueshëm e profesional, si fakultet elitare dhe që zhvillon në mënyrë të vazhdueshme karakterin intelektual të opinionit të tij në diskursin publik. Ai gjithashtu distancohet dhe u tërheqë vëmendjen të tjerëve nga çdo sjellje që përbën shkelje ligji, shkelje të rregullave etike dhe/apo e cila minon karakterin e institucionit duke e identifikuar atë me sjelljet e pahijshme në rrethe tjera shoqërore në Kosovë e më gjerë.

## Hyrje

Programi i Zyrës së Dekanit 2020 – 2024 përbën një dokument orientues mbi qasjen strategjike e planifikuese për Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ai nuk mëton të jetë një dokument përfundimtar e as juridikisht i obligueshëm, por më shumë shpërfaqje e një orientimi qëllimesh strategjike që do të ndihmoj Zyrën e Dekanit në ushtrimin sa më koherent, të planifikuar e të mirë administruar të detyrave të tij.

Programi nuk ka për qëllim që të zëvendësojë rregullativën ekzistuese sa i përket mënyrës dhe objektivave të qeverisjes; përkundrazi, qëllim në vetvete i tij është që ta bëjë më të lehtë, më transparente, të efektshme e të sigurtë zbatimin e saj.

Programi i Zyrës së Dekanit 2020 – 2024 udhëhiqet prej katër qëllimeve themelore dhe strategjike për funksionimin e rregullt të Fakultetit Juridik:

- a) Zbatimin rigoroz të ligjeve në fuqi, akteve të tjera normative dhe etikës akademike në procedurat vendimmarrëse në institucion;
- b) Ofrimin e një perspektive zhvillimore, që përmban në vete katër komponentë: ndërkombëtarizimin, një ngritje të strukturës së hulumtimit shkencor, komunikimin me publikun dhe aktivizimin akademik të studentëve;
- c) Konsolidimin dhe transparencën e politikave vendimmarrëse, në mënyrë të tillë që vendimet për çështje akademike dhe administrative të jenë të qasshme, të arsyetuara dhe të nxjerra në përputhje me legjislacioni përkatës në fuqi, pritjet legjitime dhe rregullat etike;
- d) Fuqizimin e imazhit të institucionit në diskursin publik, media dhe komunitetin akademik vendor e ndërkombëtar, në mënyrë të atillë që të theksohet karakteri universitar dhe superior i personelit dhe ekspertizës së tyre.

Bazuar në këto katër qëllime strategjike, Programi ofron një strukturë të organizuar mirë të objektivave specifike për secilën fushë e nënfushë të qeverisjes së Fakultetit Juridik. Objektivat e paraqitura shërbejnë si orientime më konkrete të qeverisjes në secilën fushë

të identifikuar në këtë Program. Zbatimi i Programit mbështetet në katër indikatorë matës të performancës, si në vijim:

- a) Raportimin e rregullt të të gjitha trupave të institucionit brenda dhe jashtë, mbi bazën e një matrikse të detajuar të aktiviteteve të planifikuara dhe shkallën e përmbushjes së tyre në baza të rregullta periodike;
- b) Rregullsinë e organizimit të procedurave administrative të vendimmarrjes dhe arsyetimin e tyre, dhe publikimin për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi të çdo vendimi të tillë;
- c) Bërjen publike të vendimeve për çështje akademike dhe jo-akademike në platformën ueb të Fakultetit, dhe në formë të printuar në tabelat zyrtare;
- d) Hapjen e Zyrës së Dekanit për komunikimin e rregullt me personelin akademik, studentët dhe administratën, në formë të tillë që të jepet përgjegjësi për arsyeshmërinë e çdo vendimi (*bazuar në një orar të saktë për takime dhe konsultime - të shpallur në ueb të fakultetit dhe tabelat zyrtare*).

Programi ndahet në kapituj, sipas fushës zhvillimore, si më poshtë:

- I. Mbarëvajtja e procesit mësimor dhe sigurimi i cilësisë;
- II. Zhvillimi i mëtejshëm i hulumtimit shkencor;
- III. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Fakultetit Juridik;
- IV. Fuqizimi i integritetit akademik;
- V. Reformimi i administratës dhe objektivizimi i saj;
- VI. Promovimi dhe nxitja e aktiviteteve të studentëve;
- VII. Rritja e rolit të Fakultetit në diskursin publik dhe komunikimi publik.

Brenda se cilës fushë ofrohet një përshkrim i shkurtër i intervenimit që do të ofrohet, dhe identifikohen disa objektiva e nën-objektiva që orientojnë aktivitetin e Fakultetit. Secila fushë përfaqëson një dimension të rëndësishëm zhvillimor të Fakultetit dhe në të njëjtën kohë është element i rëndësishëm funksional i qeverisjes nga Zyra e Dekanit.

## I. Mbarëvajtja e procesit mësimor dhe sigurimi i cilësisë

Mbarëvajtja e procesit mësimor dhe sigurimi i cilësisë në mësimdhënie është një funksion minimal dhe themelor i çdo institucioni të arsimit të lartë. Fakulteti Juridik mbështetet në parimin që studentët duhet shërbyer me cilësinë më optimale të mësimdhënies dhe mësimnxënies, nga një personel akademik kompetent, i përkushtuar dhe i aftë që të bartë njohuritë moderne e të kërkueshme për një formim cilësor të juristëve të rinj.

Një garancion i tillë mund të mirëmbahet pikë së pari duke garantuar një rregullsi teknike të mbarëvajtjes së procesit mësimor, duke u respektuar mbajtja e ligjëratave, e orëve të ushtrimeve dhe e pikave të programit sipas përcaktimit në kurrikulat përkatëse. Mbarëvajtja e tillë duhet të jetë e shoqëruar me një sistem të përshtatshëm monitorimi që mundëson vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve nga personeli administrativ,

personeli akademik, menaxhmenti i institucionit dhe vet studentët. Një vlerësim i tillë i mbarëvajtjes duhet të jetë i qasshëm për këdo, përfshirë edhe vet publikun. Studentët duhet të jenë mjaftueshëm të bindur se personeli akademik i përmbush këto detyrime në mënyrë të rregullt, dhe kjo të jetë për ta motivim i angazhimit në orët mësimore.

Përveç mbarëvajtjes së rregullt të mësimdhënies, procesi mësimor në formë, metodë dhe përmbajtje duhet të jetë i përcjellë edhe me një standard të sigurimit të cilësisë, të tillë që i përshtatet nivelit të kërkuar në një institucion të arsimit të lartë.

Zyra e Dekanit duhet të marrë përgjegjësinë për të ndërtuar një sistem transparent që e dëshmon këtë rregullsi në mënyrë periodike, dhe ta publikoj atë në portalin ueb të fakultetit në baza të rregullta. Ajo gjithashtu duhet të punoj me Zyrën e Rektorit për ta avancuar tutje procesin e digjitalizimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor, në mënyrë të tillë që të përfshijë në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve, module sikur janë: administrata *online*, formularët *online* për çdo procedurë në zyrën e shërbimeve për studentë, kushtëzimi i paraqitjes së provimeve për studentët e rregullt me pjesëmarrjen në ligjërata sipas programit/kurrikulës së studimit, komunikimin *online* me Zyrën e Dekanit, etj.

Sigurimi i cilësisë, në anën tjetër, duhet të jetë një proces i vazhdueshëm që përfshinë reformën e vazhdueshme të kurrikulës me mbështetjen e profesorëve eminentë nga universitetet me renome botërore; zhvillimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të literaturës së përdorur, përfshirë cilësinë dhe përshtatshmërinë e saj; zhvillimin e programeve të përbashkëta me universitete/fakultete të huaja (*Joint degree programs*); aplikimin për programe të studimit në gjuhë angleze, p.sh.: në nivelin Master me qëllim të ndërkombëtarizimit të fakultetit dhe rritjes së shkallës së shkëmbimit të studentëve dhe personelit akademik; hulumtimin e mundësive të bashkëpunimit dhe ndërtimit të partneriteteve ndërkombëtare me qëllim fuqizimin e komponentës së studimeve doktorale; nxitjen e personelit akademik dhe hulumtimin e mundësive për pjesëmarrje në programe të mobilitetit apo të studimeve dhe/ose hulumtimeve pas-doktorale, etj.

Objektivat specifike për fushën e 'mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe sigurimit të cilësisë' janë:

- a) Rritja e rregullsisë në mbarëvajtjen e procesit mësimor, përmes monitorimit të përshtatshëm në mënyrë sistematike dhe transparente;
- b) Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes reformimit të kurrikulave me ekspertë ndërkombëtarë, bazuar në modelet e fakulteteve juridike me të mira, në standardet e përgatitjes së juristëve cilësorë dhe në kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimeve globale në sistemin e arsimit të lartë;
- c) Përpjekja e vazhdueshme për krijimin e mundësive për avancim të personelit akademik të fakultetit si një nga prioritet kryesore;
- d) Inkurajimi i vazhdueshëm i juristëve me formim superior në universitetet me të mira botërore që të jenë pjesë e personelit akademik të rregullt dhe si

- bashkëpunëtor të jashtëm të Fakultetit Juridik – krijimi i mundësive përmes konkurrencës dhe procedurave transparente të rekrutimit;
- e) Shmangia e konfliktit të interesit dhe nepotizmit në procesin e rekrutimit të personelit akademik të rregullt dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm;
  - f) Ndërtimi i platformave që mbështesin hulumtimin dhe zhvillimin e shkathtësive të shkrimit akademik për studentët e fakultetit në të gjitha nivelet (BA, MA dhe PhD). Miratimi dhe publikimi i një manuali unik për citime;
  - g) Rritja e kapaciteteve të bibliotekës së fakultetit me literaturë bashkëkohore, sigurimi i qasjes në burime elektronike dhe reformimi/ndryshimi i ambienteve të bibliotekës;
  - h) Krijimi i mundësisë për angazhimin e një grupi të veçantë të profesorëve në pension dhe profesorëve ndërkombëtar për këshillimin e studentëve të nivelit Master dhe PhD për hulumtime dhe standardet e përgatitjes së temave të diplomës;
  - i) Analiza dhe vlerësimi kritik i programeve të nivelit Master, me vështrim të veçantë tek cilësia e punimeve të diplomës;
  - j) Analiza e kujdesshme e programeve aktuale të doktoratës që ofron Fakulteti Juridik dhe, për sa e nevojshme, riorganizimi i këtij niveli të studimeve;
  - k) Ndryshimi i rolit të studentëve të doktoratës (shkollës doktrale) përmes krijimit të mundësisë që të marrin pjesë në aktivitetet mësimore me studentët e nivelit Bachelor dhe Master (seminare, orë praktike, hulumtime, publikime). Këtij ndryshimi do ti paraprijë një proces objektiv, transparent dhe i bazuar në parimin e meritokracisë në pranimin e studentëve të doktoratës;
  - l) Përgatitja për ofrimin e programeve të studimit në gjuhë angleze, sidomos atyre Master dhe programeve të përbashkëta me fakultet juridike simotra (*Joint-degree programs*);
  - m) Ndërtimi i platformave për avancimin e metodologjisë së mësimdhënies, përfshirja e profesorëve vizitorë dhe shkëmbimi i përvojave me fakultetet juridike simotra (përmes mobilitetit të personelit akademik);
  - n) Zhvillimi i mëtejshëm i administratës digjitale për komunikimin student-institucion, dhe përfshirjen e moduleve tjera që e digjitalizojnë marrëdhënien e studentëve me shërbimin e studentëve;
  - o) Fuqizimi i elementëve të “*ndërtimit të shkathtësive*” në kurrikulat ekzistuese të Fakultetit Juridik, duke përfshirë komponentë të klinikave, punëve praktike, angazhimit në simulime gjyqësore e profesionale dhe seminareve të argumentimit;
  - p) Funksionalizimi i Zyrës për Studime Klinike (ZSK) si zyrë e përhershme që koordinon aktivitetet didaktike të lëndëve klinike në fakultet dhe bashkëpunon me ekspertët e praktikës (prokurorë, gjyqtarë, avokatë, ekspertë ligjorë, etj.);
  - q) Krijimi i mundësive për punë praktike të studentëve të fakultetit juridik bazuar në marrëveshjet me partnerë, përfshirë në veçanti programet ndërkombëtare;
  - r) Zhvillimi i një ‘*programi të nderit*’ për studentët që tregojnë aftësi të shkëlqyera, duke i promovuar ata në platforma të ngushta profesionale të tregut të punës;



- s) Fuqizimi i pjesëmarrjes së studentëve *bachelor* në programet e hulumtimit të karrierës në treg, përmes ndërlidhjes më të mirë të komunikimit të Fakultetit me organizatat profesionale. Fuqizimi i orientimit në karrierë përmes zhvillimit të një njësie të veçantë që e ndihmon këtë komponentë.

## II. Zhvillimi i mëtejshëm i hulumtimit shkencor

Hulumtimi shkencor është një funksion derivativ i procesit të mësimdhënies në një universitet, përkatësisht fakultet. Universiteti nuk është vetëm hapësirë e mësimdhënies, por natyrisht edhe e kërkimit shkencor përmes së cilit aspirohet të zhvillohet dija në fushën e caktuar. Komponenti i hulumtimit shkencor përbën një funksion kryesisht të dobësuar në botën e arsimit të lartë në Kosovë, dhe atë kryesisht për shkaqe të mungesës së financimit të tij dhe/apo pamundësisë humane për të ndërtuar një klimë serioze të hulumtimit në universitetet tona. Fakulteti Juridik nuk bën përjashtim nga një standard i tillë i përgjithshëm, prandaj edhe kanë munguar aktivitetet e diskutimit, organizimit apo edhe ndërmarrjes së përbashkët të projekteve të hulumtimit shkencor. Për këtë arsye, ky Program nuk mëton të bëjë një revolucion në këtë fushë, por megjithatë të ofrojë një përpjekje serioze në zhvillimin e mëtejshëm të hulumtimit shkencor, dhe publicitetin e botimeve të stafit akademik në platformat e saj elektronike, por jo vetëm. Personeli akademik që gëzon reputacion shkencor duhet promovuar dhe i duhet dhënë mirënjohje në çdo mënyrë të mundshme.

Zhvillimi i programeve të hulumtimit shkencor të tipit të kollokviumeve të hulumtimit, punës në vazhdim (*research in progress seminars*), diskutimeve apo orëve të recensionit të përbashkët të punimeve shkencore, duhet të jenë elemente reale të funksionimit të Fakultetit Juridik në të ardhmen. Dhënia e ndihmës për të publikuar në revista shkencore me indeksim ndërkombëtar është gjithashtu një dimension i kësaj pune. Ngritja e iniciativave për të konkurruar në projekte vendore e ndërkombëtare të kërkimit shkencor, apo edhe programe të hulumtimit që financohen nga fondet e huaja (*p.sh.: HORIZONS, European Research Agency, apo edhe aso nationale që mundësojnë bashkëaplikimin me institucione të jashtme sikur është FRA- Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, etj.*) janë aspekte të punës që do të promovohen në vazhdimësi nga Zyra e Dekanit dhe ndërmjet vet personelit akademik.

Zyra e Dekanit do të kujdeset gjithashtu për të bashkërenduar themelimin e “Grupeve bërthamë” për të konkurruar në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Përfitimi nga mundësitë e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrja në projekte të kësaj natyre do të jetë i bazuar në meritokraci: ata që japin kontribut më shumë për të konkurruar në një projekt kërkimor e për ta fituar atë, ata do të jenë bartësit e tij dhe do të përfitojnë më së shumti perspektivë akademike bazuar në të. Jo vetëm kaq. Kërkimi shkencor në Fakultet do të bashkërendohet duke e ndërlidhur me kontributin që mund të japin studentët në mbledhjen vullnetare të të dhënave primare që mund të nevojiten në hulumtimet e personelit akademik.

Objektivat specifike për fushën e “zhvillimit të mëtejshëm të hulumtimit shkencor” janë:

- a) Ngritja e një strukture të konsoliduar të hulumtimit shkencor, që bashkërendon përpjekjet e personelit akademik për të diskutuar, zhvilluar dhe fuqizuar aktivitetin shkencor në nivelin individual dhe kolektiv;
- b) Ndërtimi i një sistemi të konkurrimit për projekte të kërkimit shkencor të personelit akademik mbi bazën e parimit *'benefite për punë'*, të përcjellë me një standard transparence e organizimi që u jep qasje të barabartë secilit;
- c) Themelimi i iniciativave për diskutime të punës shkencore, të tipit të kollokviumeve, seminareve apo *“research-in-progress”*;
- d) Shfrytëzimi i mirëfilltë i mundësive për përfitim nga fondet shkencore brenda dhe jashtë vendit, dhe bërja bashkë e hulumtuesve në grupe konkurrimi;
- e) Promovimi i mirëfilltë i personelit akademik që arrin rezultate shkencore të rëndësishme në fushën ndërkombëtare, dhe dhënia e ndihmës në ndërtimin e ekipeve të hulumtuesve brenda institucionit;
- f) Zhvillimi i një programi vjetor të konferencave shkencore dhe tryezave tematike përmes së cilave do të zhvillohet dhe promovohet në publik roli dhe ekspertiza e personelit akademik të Fakultetit.
- g) Organizimi i tryezave ad hoc për tema të aktualitetit dhe me interes për publikun;
- h) Zyra e Dekanit do të krijojë mundësi reale që personeli akademik të ofrojë ekspertizën e tij për disa institucione vendore.

### III. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Fakultetit Juridik

Elementi ndërkombëtar në arsimin e lartë është bërë parakusht i cilësisë dhe horizontit qeverisës në të. Institucionet universitare që zhvillojnë mundësi ndërkombëtare për personelin akademik dhe studentët gëzojnë reputacion dhe karakterizohen nga një perspektivë aktive zhvillimore. Bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë kuptim i referohet fillimisht mundësive për bashkëpunim ndërmjet Fakultetit dhe institucioneve simotra nëpër botë në fushën e projekteve shkencore, mobilitetit të personelit, programeve të përbashkëta studimore, konkurrimi i përbashkët për projekte dhe fonde shkencore, etj. Hapja e perspektivave në bashkëpunimin ndërkombëtar për personelin akademik mundëson avancimin e metodave e dijes në mësimdhënie dhe zhvillimin e hapësirave të përbashkëta me profesorë të huaj për bashkë-hulumtim, mësimdhënie e mobilitet shkencor për kolegët e fakultetit.

Fakulteti Juridik do të punoj në disa drejtime që të fuqizoj pjesëmarrjen ndërkombëtare të tij: **a)** duke ngritur bashkërisht me personelin akademik iniciativa të bashkëpunimit me fakultete simotra në botë, dhe duke promovuar mobilitetin e personelit me këto institucione; **b)** duke bashkërenduar iniciativat në kuadër të Rektoratit të UP-së për të përfituar më shumë mundësi nga skemat aktuale të bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit (p.sh.: *ERASMUS, Fulbright, etj.*); **c)** duke aranzhuar bashkëkonkurrim me institucionet tjera simotra në projekte shkencore në nivelin Evropian e më gjerë; dhe **d)**

duke zhvilluar programe të përbashkëta studimi në gjuhë të huaja me fakultete simotra në botë, dhe duke e hapur mundësinë për shkollim të studentëve ndërkombëtar në institucionin tonë.

Fakulteti Juridik gjithashtu do të zhvilloj procedura standarde në kuptim të mënyrës se si do të ndërtohen ekipet për të konkurruar dhe përfituar nga projektet ndërkombëtare të mobilitetit, duke u dhënë përparësi atyre që ofrojnë më shumë përkushtim në punë e kredenciale akademike. Transparencë do të ketë jo vetëm mbi këtë aspekt të qeverisjes, por edhe mbi atë të përfitimeve që personeli akademik do të shfrytëzoj mbi bazën e këtij bashkëpunimi. Komponenti i bashkëpunimit ndërkombëtar do të udhëhiqet nga Zyra e Dekanit por bazuar kryekëput në rolin substancial e proaktiv të personelit akademik që tregojn interes për punën e tillë. Zyra e Dekanit do të punoj që të garantoj rregullsi të plotë në aspektet teknike të këtij bashkëpunimi, duke i bindur partnerët e institucionit mbi kredencialet dhe pastërtinë e figurës akademike të personelit të Fakultetit.

Objektivat specifike për fushën e 'bashkëpunimit ndërkombëtar' janë:

- a) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të institucionit përmes ngritjes së strukturave që e menaxhojnë këtë sektor, dhe duke organizuar personelin akademik për të fuqizuar iniciativat ndërkombëtare të tyre;
- b) Zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit me fakultete simotra, dhe fuqizimi i mobilitetit të personelit akademik me ato institucione;
- c) Fuqizimi i prezencës së Fakultetit Juridik në skemat ekzistuese ndërkombëtare përmes Rektoratit të UP-së;
- d) Ndërtimi i ekipeve që menaxhojnë segmente të caktuara të bashkëpunimit ndërkombëtar në mesin e personelit akademik dhe studentor të Fakultetit;
- e) Fuqizimi i bashkëpunimit me fakultetet juridike të rajonit, me qëllim të rrjetëzimit të përpjekjeve që adresojnë qëllime të përbashkëta.

#### IV. Fuqizimi i integritetit akademik

Integriteti akademik përbën vlerën elementare të pastërtisë dhe kuptimit të universitetit, përkatësisht fakultetit. Ai nuk ka kuptim vetëm në raport me personelin akademik por në përgjithësi me çdo proces që zhvillohet në fakultet, përfshirë mësimdhënien, publikimin, marrëdhënien me studentë dhe/apo promovimin akademik të stafit. Kjo vlerë fundamentale mbrohet duke i dhënë përparësi të vërtetës në njohuri shkencore e shkathtësi profesionale. Fakulteti Juridik është i detyruar sipas ligjeve në fuqi të zbatoj e promovoj vlerën e integritetit akademik në të gjitha shkallët dhe funksionet e saj. Programi paraqet orientimin e qartë të Zyrës së Dekanit për të zbatuar në mënyrë rigorozë parimin e integritetit akademik në çdo marrëdhënie e proces, përfshirë publikimet e personelit akademik, funksionimet e komisioneve disiplinore ndaj studentëve, rregullsinë e promovimit akademik bazuar në meritë, vendimmarrjen e

transparencën mbi të arriturat shkencore të personelit akademik, e kështu me radhë. Në anën tjetër, qëllimi që të ndërmerret çdo iniciativë që parandalon dhe dënon sjelljet abuzuese e mashtruese në proceset e provimit në lëndët e secilit program duhet të mbahet në lartësinë e duhur.

Fakulteti Juridik duhet të ndryshoj seriozisht keqkuptimin e krijuar mbi shumë praktika të gabuara në testimin e dijes së studentëve, duke dhënë shembullin e një institucioni ku funksionon disiplina dhe ruhet barazia e studentëve e bazuar vetëm në meritë. Raportet student-profesor, gjithashtu, do të objektivizohen në masën më të madhe të mundshme, duke ngushtuar diskrecionin kur janë në pyetje çështjet administrative të provimit të dijes. Personeli akademik duhet të jetë poashtu në krye të detyrës, duke dhënë shembullin e mirë se si mirëmbahet karakteri intelektual e profesional në dhënien e dijes dhe paraqitjen e arritjeve shkencore. Aspektet etike në raport me publikimet në institucion dhe/apo të personelit të tij do të shqyrtohen sa herë të jetë e nevojshme, dhe do të bëhet përpjekje për të ngritur iniciativa që i fuqizojnë ato. Fakulteti duhet të ndërmerret shembuj praktik të afirmimit të librave universitar që promovojnë vlera të dijes origjinale. Kodi Etik i Universitetit të Prishtinës do të promovohet dhe zbatohet me përpikëri, kurse studentët dhe stafi do të jenë të inkurajuar për të raportuar sjelljet që nuk janë në përputhje me të.

Objektivat specifike për 'fushën e integritetit akademik' janë:

- a) Fuqizimi i mekanizmave dhe formave të provimeve për studentë, në mënyrë të tillë që të parandalojnë dhe dënojnë sjelljet e pahijshme në procesin testues;
- b) Reformimi i thellë i kornizës së provimit dhe transparencës në notim, duke gjetur mundësi që i sanojnë dështimet që ekzistojnë në ditët e sotshme;
- c) Promovimi i rregullsisë së paraqitjes së publikimeve të personelit akademik në platformat zyrtare, dhe ndërtimi i një politike avokuese kundër publikimeve që nuk plotësojnë standardet etike;
- d) Promovimi i Kodit Etik të UP-së në qarqet e studentëve por edhe personelit, me qëllim të nxitjes së raportimeve që dëshmojnë shkeljet eventuale të tij. Denoncimi i çfarëdo forme të abuzimit të personelit akademik, e sidomos i rasteve të ngacmimit seksual, marrjes së mitos apo keqpërdorimeve tjera;
- e) Fuqizimi i mekanizmave disiplinor të institucionit në raport me shkeljet e studentëve, dhe bërja e transparencës së vendimeve të tilla;
- f) Avokimi në organet qendrore të UP-së në favor të shtrëngimit të masave ndaj shkelësve të etikës akademike.

## V. Reformimi i administratës dhe objektivizimi i saj

Administrata është dega më operative në ushtrimin efektiv të funksioneve të fakultetit. Kompleksiteti i vendimmarrjes së saj, mungesa e transparencës dhe diskrecioni i gjerë në vendimmarrje janë zakonisht barriera që ngadalësojnë dhe nxisin kontestime në punën

e saj. Fakulteti Juridik ka një shërbim administrativ relativisht të vogël në numër, megjithatë funksioni i saj është qenësor për të mirëmbajtur imazhin e institucionit në raport me studentët dhe për të siguruar mbarëvajtjen e mësimdhënies.

Administrata e Fakultetit ka nevoja të shumta, përfshirë rritjen e personelit, profesionalizimin e mëtejshëm, rritjen e transparencës dhe shtimin e resurseve jo-humane. Programi ka për qëllim të bëjë një reformë thelbësore në mënyrën e funksionimit të saj, nëse jo organizimit. Element i parë në këtë aspekt është digjitalizimi maksimal i marrëdhënies student-shërbim administrativ; sa më i madh të jetë digjitalizimi, aq më të pakta do të jenë radhët e pakënaqësisë dhe pabarazisë në shërbimin për studentë. Digjitalizimi i skajshëm, përmes zhvillimit të moduleve të reja, do të mundësojë gjithashtu zvogëlimin e diskrecionit administrativ në trajtimin e parashtresave të studentëve. Digjitalizimi i mëtejshëm do të mundësojë forma standarde të parashtresave, dhe barazi në vendosjen për to. Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar apo i privilegjuar në marrjen e një shërbimi që bazë ka meritën akademike. Prandaj, digjitalizimi do të mundësojë këtë aspekt.

Element i dytë është rritja maksimale e pamundësisë për të intervenuar në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve sa i përket mënyrës së ndarjes së grupeve të ligjëratave apo provimeve. I vetmi kriter që duhet të përcaktojë këtë të fundit duhet të jetë kriteri i rastësisë. Element i tretë është ndërtimi i një ambienti ku prezenca fizike në ambientet e Fakultetit do të ulët maksimalisht, duke bërë përpjekje për organizim të ligjshëm digjital të çdo veprimi e vendimmarrje. Në anën tjetër, Programi synon të transformoj funksionimin ditor të administratës, duke i dhënë koordinimit të brendshëm një fokus të veçantë. Koordinimi dhe zbatimi i detyrave të karakterit administrativ do të bëhet me burokraci minimale, dhe një llogaridhënie të plotë. Vendimet do të jenë të formës së shkruar, dhe ato do të bëhen transparente e të ruhen në përputhje me standardet e mira arkivore. Paligjshmëritë në vendimmarrjen e tillë do të ndalohen me rreptësinë më të madhe.

Shërbimi i teknologjisë informative do të transformohet thelbësisht në bashkëpunim me Rektoratin gjithashtu, duke e pamundësuar ndërhyrjen në çfarëdo sistemi që mban të dhëna personale. Në mënyrë të veçantë do të ndërtohet një sistem i monitorimit dhe objektivizimit që pamundëson ndërhyrjet e pakontrolluara në SEMS.

Studentëve do tu bëhet i qashtë në mënyrë të shpejtë një portal për studentë, i cili do tu ofroj shërbime online për problemet që mund t'u lindin atyre në lidhje me funksionimin e sistemit elektronik, aspekt që do të jetë i monitoruar në mënyrë objektive.

Do të instalohet një proces i koordinimit dhe llogaridhënies periodike brenda administratës, dhe i cili do të promovojë punëtorët që ushtrojnë në mënyrë të rregullt dhe kanë performancë të shquar në punë. Zyra e Dekanit do të ndalojë çfarëdo ndërhyrje në punën e administratës, aty ku ligji dhe rregullativa në fuqi përcakton se shërbimi administrativ ta zbatoj një detyrim pa ndërhyrje.

Objektivat specifike për fushën “reformimi i administratës dhe objektivizimi i saj” janë:

- a) Planifikimi i një reforme të mirëmënduar, e të konsultuar gjerësisht me personelin administrativ dhe akademik, që e transformon funksionin e administratës së Fakultetit në një të tillë që i shërben më me thjeshtësi studentit dhe personelit, që vepron me një efektivitet më të lartë, dhe që ka një maksimizim të digjitalizimit të veprimeve të saj ku zvogëlohet skajshëm diskrecioni human;
- b) Rindërtimi i mënyrës së koordinimit të stafit administrativ, përmes një sistemi në të cilin Zyra e Dekanit nuk ndërhyr por mbikëqyr, dhe i cili garanton një llogaridhënie të qartë e periodike, dhe raportim të saktë mbi çdo të dhënë;
- c) Zhvillimi i një sistemi digjital që rregullon marrëdhënien me studentë, dhe që e bën të panevojshme kontaktin fizik ndërmjet studentit dhe administratës, përfshirë në mënyrë të veçantë informatat dhe asistencën për shërbimet e SEMS-it;
- d) Zhvillimin e një standardi të qartë të formave të parashtrësive të studentëve dhe personelit, në mënyrë që të garantohet barazia e palëve dhe të parandalohet diskriminimi potencial;
- e) Rritjen e kapaciteteve humane dhe jo-humane në administratën e Fakultetit, me theks të veçantë në aspektet që lidhen me marrëdhënien me studentë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Angazhimi për përmirësimin e pozitës materiale të personelit të administratës dhe stimulimit të tyre sipas performances ne punë;
- f) Parandalimin dhe mbylljen e hapësirave që ekzistojnë brenda praktikave aktuale për ndërhyrje në çështjet që janë të tipit të përcaktuar qartësisht me legjislacion në fuqi, e për të cilat administrata nuk gëzon diskrecion;
- g) Ndalimin e praktikave të ndërhyrjes së Zyrës së Dekanit në zhvillimin e procedurave administrative në Fakultet, për të cilat kompetent është stafi civil.

## VI. Promovimi dhe nxitja e aktiviteteve të studentëve

Studentët janë arsyeja primare për të cilën ekziston universiteti/fakulteti. Ata nuk janë vetëm një klient ndaj të cilit duhet dhënë shërbimi i mësimdhënies, por edhe një pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e fakultetit dhe ndërtimit të kulturës së dijes e debatit për të. Aktivizimi i studentëve për nevoja dhe qëllime të vet atyre, dhe me qëllimin që ata të jenë pjesëmarrës të vërtetë në një komunitet akademik, përbën një praktikë të munguar në Fakultetin Juridik. Angazhimi i tyre megjithatë duhet bërë jo me qëllim të adresimit të një kulture krejtësisht të gabuar për të fuqizuar nevojat e individëve brenda institucionit dhe/apo politikës publike, por për të zhvilluar perspektivën intelektuale e profesionale të vet studentëve. Një angazhim të tillë duhet bërë në përputhje me parimet e etikës akademike, që nënkupton ndalim të çfarëdo angazhimi studentor për qëllime të politikës së partive, individëve brenda institucionit apo edhe vet kauzave që në rrënjë nuk përkojnë me qëllimin e edukimit në përgjithësi.

Fakulteti Juridik do të shndërrohet në një hapësirë ku roli i studentit do të fuqizohet maksimalisht, në korniza të një pjesëmarrjeje të shtuar në debate publike, angazhime për punë minimale hulumtuese, projekte kërkimore dhe punë praktike. Studentët më nuk do të jenë një segment i nëpërkëmbur i menaxhimit publik, por një partner për të zhvilluar bashkërisht programe që i afirmojnë debatin mbi dijen, komunikimin publik, karrierën dhe ekselencën në studime dhe punë praktike profesionale. Programi fillimisht parasheh ndërtimin e “Grupeve bërthamë” që do të zhvillojnë programe të aktivizimit të studentëve, e që reflektojnë praktika të ngjashme të universiteteve në vende të zhvilluara. Programe të tilla do të përfshijnë fusha siç janë debatet e hapura me shkollarë e figura publike në fushat me interes për studentët e drejtësisë, promovimin e lidershit e mendimit kritik, pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare të fushës së ngushtë profesionale, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e rezultateve në çështje me interes profesional, zhvillimin e konferencave publike me komponentë të përzier profesional-studentor, zhvillimin në karrierë, etj.

Promovimi i rolit të studentëve në komunitetin akademik, në opinionin publik dhe në përgjithësi në media do të jetë theks i veçantë i organizimit të punës në Zyrën e Dekanit, dhe kjo do të shprehet qartësisht edhe në detyrat konkrete të menaxhmentit të fakultetit. Programi ka për qëllim që studentëve të ekselencës tu jepet hapësirë e vërtetë për promovim, zhvillim të lidershit e aftësisë për fjalime publike, dhe për ndërtim kauzash që përkrijnë me qëllimet e nxënies së dijes dhe formimit cilësor për juristët e së ardhmes.

Objektivat specifike për fushën e “promovimit dhe nxitjes së aktiviteteve të studentëve” janë:

- a) Zhvillimi i programeve të veçanta për studentë për të promovuar pjesëmarrjen dhe organizimin e debateve publike, ligjëratave të hapura, mendimit kritik dhe pjesëmarrjes në aktivitete mediale;
- b) Mbështetja e studentëve për organizimin e përhershëm të programit “Guest speaker”;
- c) Bashkërendimi i grupeve të studentëve të ekselencës në “Grupe bërthamë”, në mënyrë të tillë që t’i organizoj ata dhe tu ndihmoj atyre në arritjen e qëllimeve të caktuara. Krijimi i grupeve të përbashkëta të studentëve të Fakultetit juridik me studentët e universiteteve tjera (p.sh.: Krijimi i “Grupit të studentëve të ekselencës” me studentët e fakultetit dhe studentët e huaj), organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, krijimi i revistave/platformave studentore, etj.;
- d) Promovimin e aktiviteteve studentore në media, dhe vendosjen e studentit në qendër të aktivitetit publik me qëllim të nxitjes së tyre për të zhvilluar liderшип në një fushë të caktuar juridike dhe jo vetëm;
- e) Zhvillimin e programeve të studentëve që themelojnë një garë ‘Moot court’ vendore, dhe nxitjen e përgatitjen e tyre për pjesëmarrje e tyre në gara ndërkombëtare;

- f) Rindërtimin e marrëdhënies komunitet studentor - Zyrë e Dekanit, me qëllim të bashkërendimit të një agjende pune ku përfiton vetëm studenti në kuptimin akademik e intelektual të fjalës;
- g) Hulumtimin e mundësive ndërkombëtare për mobilitet studentor, gara e evente studentore, dhe zhvillimin e proceseve të hapura për konkurrim;
- h) Udhëzimi dhe mbështetja e studentëve për anëtarësimi të organizata profesionale.

## VII. Rritja e rolit të Fakultetit në diskursin publik dhe komunikimi publik

Fuqia intelektuale e një komuniteti akademik është thelbësisht e lidhur me pjesëmarrjen e tij në diskursin publik, dhe ndërtimin e kauzave intelektuale e arsyetimin e tyre në një debat publik. Komuniteti akademik nuk mund të mbyllet përballë debatit, por i duhet marr përsipër drejtimin e tij bazuar në një perspektivë akademike e intelektuale. Marrëdhënia e universitetit me diskursin publik dhe median në përgjithësi është shumë e dobët, ose të paktën dobësisht e konstruktuar. Sa më prezent të jetë imazhi i fakultetit në diskursin publik aq më i fuqishëm është imazhi e roli i tij akademik, dhe aq më shumë ka kuptim karakteri i pavarur i dijes shkencore të personelit akademik. Prandaj, Programi synon që Fakulteti Juridik të jetë një qendër e fuqishme e vëmendjes së opinionit publik dhe medias në çështjet ku ekspertiza e saj është e nevojshme, dhe ku dija e shkathtësitë e personelit akademik e bëjnë të arsyetuar mendimin e tyre.

Programi synon ndërtimin e një marrëdhënie aktive me median e opinionin publik, përmes organizimit të eventeve shkencore e profesionale, dhënies së opinionëve profesionale për media, dhe motivimit të stafit akademik që të promovoj statusin e tyre të ekspertit në media. Një perspektivë e tillë do të rriste funksionin intelektual e akademik të Fakultetit në përgjithësi, dhe do të përçonte ndikimin intelektual të një perspektive të tillë. Programi synon një marrëdhënie të hapur me median, një kulturë intervenimi në debat publik sa herë që ekspertiza e personelit akademik të Fakultetit është e nevojshme, dhe në çdo rast kur vet Fakulteti planifikon të ushtroj një rol avokues. Në anën tjetër, ndriçimi dhe fuqizimi i marrëdhënies së Fakultetit me qendrat e vendimmarrjes ku kërkohet apo nevojitet ekspertiza e personelit akademik do të eksplorohet maksimalisht, e në veçanti në kuptim të ekspertizës në procesin ligjberës pranë komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo grupeve punuese të institucioneve ekzekutive apo donatorëve të huaj. Ky aspekt do të jetë një kujdes i posaçëm i Zyrës së Dekanit për krijimin e hapësirës për të gjithë personelin akademik të Fakultetit, në varësi të ekspertizës së gjithsecilit.

Objektivat specifike për fushën e “rritjes së rolit të Fakultetit në diskursin publik dhe komunikimi publik” janë:

- a) Aranzhimi i një strategjie kuptimplotë të komunikimit publik, përmes së cilës zhvillohet një marrëdhënie e plotë profesionale ndërmjet medias dhe ekspertizës së personelit akademik të Fakultetit;



- b) Zhvillimi i një programi të mirëplanifikuar të eventeve publike të Fakultetit, me tema që nxisin debat e përbëjnë kauza të mirëfillta publike dhe intelektuale;
- c) Fuqizimi i emrit të Fakultetit në media, përmes theksimit të statusit të stafit akademik sa herë që ata paraqiten për opinione profesionale në media;
- d) Organizimi i një “Grupi bërthamë” që orienton median në stafin që gëzon kompetencë profesionale për dhënie opinionesh, dhe koordinim të një përpjekje të tillë nga Zyra e Dekanit;
- e) Fuqizimi i portalit ueb të Fakultetit duke e lehtësuar dhe mirëstrukturuar informacionin mbi ekspertizën e personelit akademik, dhe qartësuar fushat ku ata janë të qasshëm për media (ngjashëm me universitetet e zhvilluara);
- f) Mbajtja e qëndrimeve publike të Fakultetit në çështje thellësisht të ngushta profesionale, e për të cilat ekziston detyrimi intelektual i Fakultetit për të reaguar publikisht, sidomos për procese devijante nga fusha e sundimit të ligjit, si dhe ajo e arsimit të lartë në Kosovë;
- g) Hapje të plotë të Zyrës së Dekanit për interesin e medias në çështje që lidhen me aktivitetin e Fakultetit;
- h) Krijimi i hapësirës për personelin akademik për të ofruar ekspertizë për institucionet e Republikës së Kosovës (Kuvendin e Kosovës, etj.) dhe jo vetëm.

### Një rrugëtim i gjatë strategjik e bashkëpunues

Ky dokument nuk mëton të jetë një instrument ngurtësimi; ai është një bazë që kërkon të zhvillohet, plotësohet dhe t’i përshtatet dinamikës së punës së Fakultetit Juridik. Prandaj, ky do të na shërbej të vlerësojmë premtimet e dhëna dhe mbajtjen e tyre në praktikë nga Zyra e Dekanit. Ai gjithashtu përbën një rrugëtim që do të na përcjell për një kohë të gjatë. Prandaj, shpresojmë që të gjithë do të jenë ndihmëtarë në adresimin e këtij orientimi në mënyrë të përgjegjshme dhe me një sinqeritet të vërtetë intelektual. Zbatimi i tij sa më i plotë do të na bëjë të gjithëve të fituar, kurse institucioni i Fakultetit Juridik do të marr një zhvillim e pamje krejt ndryshe, e shumë herë më të respektuar e të vlerësuar.